

**AKT THEMELIMI  
"KUZA B.V & PALMIROIL " SHPK**

**AKT- THEMELIMI I SHOQERISE  
"KUZA B.V & PALMIROIL " SHPK**

**1. EMRI DHE FORMA LIGJORE E SHOQERISE**

Ne baze te ligjit nr. 9901 dt,14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ligjit nr.129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9901 dt,14.04.2008 Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, sot ne daten 07.06.2021 behet themelimi i shoqerise "KUZA B.V & PALMIROIL " SHPK. Shoqeria eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare e formes me pergjegjesi te kufizuar (SHPK).

**2. ORTAKET E SHOQERISE**

Shoqeria eshte themeluar nga ortaket:

1. **Z. David Julian Lake** , lindur më 07.07.1981, në San Pedro de Macoris, mbajtës i pashaportes me nr: NM7D10JL4 , madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
2. **Z. Përparim Gropa**, lindur më 13.04.1960, banues në Patos, Fier, Shqipëri, mbajtës i pashaportes me nr. BI4871524, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**3.SELIA E SHOQERISE**

1. Shoqëria ka selinë e saj në adresën : **Lagjja "29 Marsi", Rruga e Gropallareve, Banesa 39, Patos, Fier, Shqiperi.**
2. Shoqeria mund te shtrihe aktivitetin ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise . Ajo mundet te themeloje dege, ose zyra perfaqesimi brenda territorit te Republikes se Shqiperise , si dhe jashte tij.



## AKT THEMELIMI

### "KUZA B.V & PALMIROIL " SHPK

3. Selia e shoqërisë mundet të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

#### 4. OBJEKTI I AKTIVITETIT

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Menaxhim fondesh për blerjen e rafinerisë, menaxhim transaksionesh të ndrushme në sektore si : energji, turizëm dhe të tjera. Konstruksion, prodhim betoni, punime dheu, sistemime tarracime terrenesh, ndërtime civile, ndërtime godinash, ekonomike, rikonstruksione godinash. Infastruktura, ndërtim rrugësh, autostrade, asfalt beton. Tregtim perpunim Produktesh bujqësore, mbarështim. Import eksport të mallrave të ndryshëm me shumicë dhe pakicë.

Shërbime ndërmjetësimi, të agjentit tregtar, të komisionerit dhe të brokerit në të gjitha fushat.

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë apo të lejuar nga ligji i vendit të selisë, në rastin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### 5. KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

1. Periudha e aktivitetit të shoqërisë është e pakufizuar.
2. Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të bëhet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

#### 6. KAPITALI THEMELTAR

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 10.000 (dhjetë mijë lekë).
- Kapitali themeltar është i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale 5.000 mijë leke secila.



## AKT THEMELIMI

"KUZA B.V & PALMIROIL " SHPK

- Te gjitha kuotat e shoqërisë zoterohen nga:

1. Ortaku Z. David Julian Lake është zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme ALL 5.100 (pese mijë e njeqind leke) që përfaqëson 51% (pesedhjetë e një përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  
3. Ortaku Z. Përparim Gropa është zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme ALL 4.900 (katër mijë e nenteqind leke) që përfaqëson 49% (dyzet e nente përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## 7. ORGANET E VENDIM MARRJES SE SHOQERISE

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:

- Administratori.
- Asambleja e Përgjithshme.

## 8. ADMINISTRATORI

- Administratori i parë i shoqërisë është Z. David Julian Lake, shtetas Holandez, lindur më 07.07.1981, në San Pedro de Macoris, mbajtës i pashaportes me nr: NM7D10JL4 , madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Menyra e emerimit , shkarkimit , te drejtat dhe detyrimet e administratorit si dhe koha e qendrimit ne detyre te tij percaktohen ne Statut dhe ligj.

## 9. MBYLLJA LIKUJDIMI I SHOQERISE

Ne rast te falimentimit te shoqerise , procesi i likujdimit do te realizohet ne perputhje me procedurat ligjore ne fuqi ne momentin e falimentimit.

ORTAKËT




AKT THEMELIMI  
"KUZA B.V & PALMIROIL " SHPK

Z. David Julian LAKE



Z. Përparim GROPA



Përkthyesë : Znj.

